

VENDIM
Nr. 6, datë 6.1.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “VOLTON” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.1.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2584/1 prot., datë 27.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Volton’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Volton” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2584 prot., datë 19.12.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gjerat: “a”, “b” dhe “c”; si dhe për pikën 1.2, gjerat: “a”, “b” dhe “d”.

- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet dhe informacioni/dokumentacioni në vijim:

Neni 9. Format i dhe dokumentacioni për aplikim:

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë:

- germa “c”: Shoqëria duhet të depozitojë dokumentin mbi strukturën organizative të saj me nënshkrimin dhe/ose vulën përkatëse;

- Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa “a”: Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

- germa “b”: Shoqëria duhet të dokumentojë aftësinë financiare për të garantuar ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike për të paktën 1 muaj, në përputhje me parashikimet e planit të biznesit. Edhe pse është depozituar një kontratë huaje e datës 22.10.2024, midis “*Albanian Development Company ADC*” sh.p.k. dhe “Volton” sh.p.k., kjo shumë është përdorur për dokumentimin e mbështetjes financiare në kuadër të një licence të mëparshme për furnizim me energji elektrike dhe nuk mbulon tërësisht nevojën financiare për tregtimin e parashikuar;

- germa “c”: Shoqëria duhet të depozitojë planin e biznesit me nënshkrimin dhe/ose vulën përkatëse dhe ta plotësojë atë me sasinë që parashikon të tregtojë dhe për 4 vitet e tjera të licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Volton” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Volton” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti